

**VENDIM**  
**Nr.549, datë 7.7.2010**

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE**  
**NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) në qarkun Tiranë, 1925 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 669 294,18 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër presje tetëmbëdhjetë) m<sup>2</sup>;

b) në qarkun Durrës, 760 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 268 505,66 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë presje gjashtëdhjetë e gjashtë ) m<sup>2</sup>;

c) në qarkun Shkodër, 118 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 23 817,44 (njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë presje dyzet e katër) m<sup>2</sup>;

ç) në qarkun Lezhë, 41 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 653,62 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre presje gjashtëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>;

d) në qarkun Berat, 43 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 14 305,70 (katërmëdhjetë mijë e treqind e pesë presje shtatëdhjetë) m<sup>2</sup>;

dh) në qarkun Fier, 400 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 100 190,65 (njëqind mijë e njëqind e nëntëdhjetë presje gjashtëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>;

e) në qarkun Korçë, 18 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 630,45 (katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë presje dyzet e pesë) m<sup>2</sup>;

ë) në qarkun Elbasan, 178 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 35 606, 90 (tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtë presje nëntëdhjetë) m<sup>2</sup>;

f) në qarkun Gjirokastrë, 10 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 468,40 (tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë presje dyzet) m<sup>2</sup>;

g) në qarkun Vlorë, 111 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 44 204,90 (dyzet e katër mijë e dyqind e katër presje nëntëdhjetë) m<sup>2</sup>;

gj) në qarkun Kukës, 13 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 492,72 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>.

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**